



Kushtet e Përgjithshme të Kampanjës Back to School me NLB

Kampanja promociionale **“Back to School me NLB”** organizohet nga NLB Banka dhe është e vlefshme nga **27 gusht deri më 7 shtator 2026**.

Në kuadër të kampanjës, klientët që realizojnë pagesa të kualifikuara me kartelë NLB mund të përfitojnë 10% Bonus, si dhe të marrin pjesë automatikisht në lojën shpërblyese për të fituar shpërblimet e përcaktuara në këto kushte.

1. Periudha e kampanjës

Kampanja fillon më 27 gusht 2026 dhe përfundon më 7 shtator 2026.

Vetëm transaksionet e realizuara dhe të kualifikuara brenda kësaj periudhe do të merren parasysh për përfitimin e Bonusit dhe pjesëmarrjen në lojën shpërblyese.

2. Kush mund të përfitojë?

Në kampanjë mund të marrin pjesë klientët që:

- posedojnë kartelë NLB të vlefshme dhe aktive;
- realizojnë pagesa me kartelën NLB gjatë periudhës së kampanjës;
- kryejnë pagesat në POS терминаlet e NLB Bankës te tregëtarët pjesëmarrës në kampanjë.

Pjesëmarrja në kampanjë është automatike për transaksionet që i plotësojnë kriteret e përcaktuara në këto kushte.

3. Përfitimi i Bonusit

Për çdo pagesë të kualifikuar gjatë periudhës së kampanjës, klienti përfiton 10% Bonus nga vlera e transaksionit.

Shuma maksimale e Bonusit që mund të përfitohet është 15€ për kartelë, gjatë gjithë periudhës së kampanjës.

Pas arritjes së limitit maksimal prej 15€ për kartelë, transaksionet e tjera të realizuara gjatë fushatës nuk gjenerojnë Bonus shtesë për atë kartelë.

Bonusi aplikohet vetëm për transaksionet që i plotësojnë të gjitha kriteret e kampanjës.

4. Pjesëmarrja në lojën shpërblyese

Çdo pagesë e kualifikuar e realizuar gjatë periudhës së kampanjës përfshihet automatikisht në lojën shpërblyese.

Për pjesëmarrje nuk kërkohet aplikim apo regjistrim shtesë nga klienti.

Stafi i NLB Bankës përjashtohet nga loja shpërblyese dhe nuk ka të drejtë të përfitojë shpërblimet e përcaktuara në kuadër të kësaj kampanje.

5. Shpërblimet

Në kuadër të lojës shpërblyese do të ndahen gjithsej 14 shpërblime:

- **1 Laptop Lenovo** – IdeaPad/V15, i5, 16GB RAM;
- **3 iPad** – model bazë, 11", Wi-Fi, 128GB;
- **10 çanta shkollore.**

Shpërblimet nuk mund të konvertohen në para dhe nuk mund të zëvendësohen me një përfitim tjetër, përveç rasteve kur NLB Banka përcakton ndryshe.

6. Tregëtarët pjesëmarrës

Kampanja realizohet në bashkëpunim me tregëtarë partnerë në mbarë Kosovën. Bonusi dhe pjesëmarrja në lojën shpërblyese vlejnë vetëm për transaksionet e realizuara me kartelë NLB në POS terminalët e NLB Bankës të tregëtarët pjesëmarrës në kampanjë.

Lista e tregëtarëve pjesëmarrës është publikuar në webfaqen zyrtare të NLB Bankës.

7. Transaksionet e pakualifikuara

Transaksionet që nuk i plotësojnë kriteret e përcaktuara në këto kushte nuk do të merren parasysh për përfitimin e Bonusit dhe/ose pjesëmarrjen në lojën shpërblyese.

Transaksionet e anuluar, të kthyera apo të rimbursuara mund të përjashtohen nga përfitimet e kampanjës dhe nga loja shpërblyese.

NLB Banka rezervon të drejtën të verifikojë vlefshmërinë dhe statusin e transaksioneve përpara ndarjes së Bonusit apo shpërblimeve.

8. Përzgjedhja e fituesve

Fituesit do të përzgjidhen pas përfundimit të periudhës së kampanjës.

Përzgjedhja e fituesve do të bëhet në mënyrë të rastësishme përmes platformës Easypromos App, nga të gjitha pjesëmarrjet e kualifikuara në lojën shpërblyese.

Pas përzgjedhjes së rastësishme, NLB Banka do të verifikojë nëse personat e përzgjedhur i plotësojnë të gjitha kriteret dhe kushtet e pjesëmarrjes.

Nëse një person i përzgjedhur nuk i plotëson kushtet e kampanjës, përfshirë rastet kur personi është pjesë e stafit të NLB Bankës, ai/ajo do të skualifikohet dhe nuk do të ketë të drejtë në shpërblim.

Në raste të tilla, Banka mund të realizojë përzgjedhjen e një fituesi tjetër në mënyrë të rastësishme përmes Easypromos App.

9. Njoftimi dhe pranimi i shpërblimeve

Fituesit do të shpallen pas përfundimit të kampanjës dhe përfundimit të procesit të verifikimit.

NLB Banka do t'i kontaktojë fituesit përmes të dhënave të kontaktit që Banka ka në dispozicion dhe do t'i informojë për mënyrën, vendin dhe afatin e pranimi të shpërblimit. Para dorëzimit të shpërblimit, Banka mund të kërkojë verifikimin e identitetit dhe plotësimin e kushteve të tjera të nevojshme për konfirmimin e fituesit.

Nëse fituesi nuk mund të kontaktohet, nuk i plotëson kushtet e kampanjës ose nuk e pranon shpërblimin sipas mënyrës dhe afatit të përcaktuar nga Banka, NLB Banka rezervon të drejtën të përzgjedhë një fitues tjetër.

10. Mbrojtja dhe përpunimi i të dhënave

Të dhënat e klientëve do të përpunohen nga NLB Banka vetëm në masën e nevojshme për realizimin dhe administrimin e kampanjës, verifikimin e pjesëmarrësve, përzgjedhjen dhe kontaktimin e fituesve, si dhe përmbushjen e detyrimeve ligjore dhe rregullative të Bankës.

Përpunimi i të dhënave personale do të bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe politikat përkatëse të NLB Bankës për mbrojtjen e të dhënave personale.

11. Keqpërdorimi dhe përjashtimi nga kampanja

NLB Banka rezervon të drejtën të përjashtojë nga kampanja çdo pjesëmarrës ose transaksion për të cilin konstatohet keqpërdorim, mashtrim, manipulim apo tentim për të përfituar në kundërshtim me këto kushte.

Në raste të tilla, Banka mund të anulojë të drejtën për Bonus dhe/ose pjesëmarrjen apo shpërblimin nga loja shpërblyese, në përputhje me kushtet e kampanjës dhe legjislacionin në fuqi.

12. Dispozitat përfundimtare

NLB Banka rezervon të drejtën të ndryshojë, plotësojë, pezullojë ose përfundojë kampanjën në rast se një gjë e tillë kërkohet nga rrethanat, kërkesat ligjore apo rregullative.

Çdo ndryshim eventual në kushtet e kampanjës do të komunikohet përmes faqes dhe/ose kanaleve zyrtare të NLB Bankës.

Për çështjet që nuk janë të rregulluara shprehimisht me këto kushte, zbatohen kushtet e përgjithshme të NLB Bankës dhe legjislacioni në fuqi.

Pjesëmarrja në kampanjën “Back to School me NLB” nënkupton pranimin e këtyre kushteve dhe rregullave të kampanjës.